

Jo Armos



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. Ufaq Broj stranica Nr. pages	01
Nr Prot Br Prot Prot No	03-3182/12
Data Datum Date	12.09.2012
PRISHTINE	



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 18231/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Murat Vokshi nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 9 te Ligjit nr. 04/L -050 per Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, dhe Kontrollin e Dhuratave per të gjithë peronat Zyrtar, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 al.1.pika 10 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dt. 31.08.2012 merrë këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Murat Zeq Vokshi I lindur 30.06.1959 ne Voksh – Deqan, tani më vendbanim në Prishtinë rr. Muharrem Fejza pn, për kundërvajtje nga neni 9 te Ligjit nr. 04/L -050 per Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë peronat Zyrtar

Konform neni 198 al.1 pik. 10 te LMK-es Pezullohet Procedura kundervajtese ndaj te lartepemendurit. pasi qe parashtrusi I kerkeses ka hjek dorë nga kerkesa, pasi qe pala nuk është e obliguar qe ta plotësoj ketë fermullar.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtrori kërkesën nr. 01-1825/2012 të dt 22.05.2012, për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartepemendurit e për kundërvajtjen e lartcekur.

Ne baze te kerkeses u muarr ne pyetje i lartepemenduri I cili pohoj se unë e kam deklaruar formularin per deklarimin e pasurisë në agjension me vonës prej një dite ku e kam dërguar me dt. 03.04.2012 dhe atë e kam llogarit se data I ka ra dite e shtune dhe kjo bartet me here nuk e kam dërguar se nuk kam pranuar formularin, datën te cilen e ceka ma herët per çka është ma me rendësi, se neni 3 ku përkufizohen paragrafi 1 se zyrtaret e lartë public paragrafi 1.1 p. 18 është I përfshi vetëm kryer inspektori I inspektove te nivelit qendror dhe lokal ndërsa unë e kam pozitën e zëvendës kryeinspektorit, ku nga kjo dispozit shihet se unë nuk jam I obliguar pa paraqes pasurin si zyrtar public, me qe e kundërshtoj kërkesën si e pa bazuar

Ne deklarate e dhanë te parashtruesi te kërkesës Enis Sadiku i cili deklaroi se ne momentin qe ne mbajmë trajnim ju tregojmë pika kontaktuese se në bazë të Ligjit kush janë personat e obliguar qe ta paraqesin pasurin , ne rastin konkret e kam shkura dispozitat konkrete 1.1 pika 18 ku përfshihen vetëm kryer inspektorat e- inpektorve te nivelti qendror , ndërsa Murati shihet se ka pozitë zyrtare zavendes kryeinspektori i trupave ekzekutive te inspektorëve te punës, me çka nuk është i obliguar ta paraqes pasurin ne agjensionin dhe nga kjo gjendje hjek dorë nga kërkesa si e pa arsyeshme dhe e pa bazuar.

Sipas kerkesës se ushtruar dhe provav te tjera te adminstruar ne lend , gjyqtari Konform neni 198 al.1 pik. 10 te LMK-es Pezullohet Procedura kundervajtese ndaj te lartepemendurit. pasi qe parashtrusi I kerkeses ka hjek dorë nga kerkesa, pasi qe pala nuk është e obliguar qe ta plotësoj ketë fermullar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë brenda 8 ditësh pas marrjes së të njejtit përmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Gjyqtari për kundërvajtje:

Fatmir Behrami

